

Njoftim për mbledhjen plenare datë 10.04.2020 me anë të vendimeve qarkulluese

POSTED 10/04/2020 KLP



Në situatën e krijuar nga pandemia e COVID 19 në vendin tonë dhe në respektim të plotë të udhëzimeve dhe kufizimeve të paraqitura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe qeveria shqiptare për mbrojtjen e popullatës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi sot paradite mbledhjen plenare të radhës nëpërmjet platformës on-line ku morën pjesë të nëntë anëtarët e Këshillit.

Në përgjigje të thirrjes së Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi e drejtuar institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të krijuara me ligj me shkresë zyrtare me datë 2 Prill 2020 mbi kontributin financiar për lehtësimin e përballimit të situatës së pandemisë COVID 19 dhe në vazhden nëpërmjet përgjysmimit të pagave për drejtuesit të lartë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi në mënyrë unanime për t'i përgjigjur pozitivisht kësaj nisme në shenjë solidariteti me qytetarët shqiptarë të prekur nga masat ndaluese të kësaj pandemie, duke përgjysmuar pagën mujore të anëtarëve të Këshillit.

Gjithashtu, përpos kontributit në masë 50% nga paga mujore e anëtarëve të Këshillit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të vendos në dispozicion të Ministrisë së Financave një shumë rreth 7,8 milion lek nga fondi i pagave të cilit Këshilli nuk do ta shpenzojë për vitin 2020.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, vendosi të miratojë tërheqjen nga kandidimi për tu emëruar prokuror në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të znj.

Anita Jella me kërkesë të saj dhe deklarojë të përfunduar procedurën e ngritjes në detyrë për znj. Jella.

Si rrjedhojë, Këshilli vendosi të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 1 (një) vendi vakant për prokuror në Prokurorinë e Posaçme përmes procedurës së ngritjes në detyrë dhe të caktojë Komisionin e Posaçme për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e prokurorëve të SPAK dhe të ndjekë e të zbatojë procedurat paraprahe për plotësimin e kushteve nga kandidatët.

Shprehja e interesit duhet të dorëzohet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga publikimi i shpalljes në faqen zyrtare të institucionit.